



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 300 Prot.

Tiranë, më 25. 02. 2019

V E N D I M

Nr. 28, Datë 25. 02. 2019

Mbështetur në nenin 32/1/a të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 190 Regj., datë 17.12.2018, e shoqatës “Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome”¹, kundër I. B., me pretendimin diskriminim për shkak të “racës”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në informacionin e ardhur nga Shoqata LRER², lidhur me një status të publikuar më datë 10.12.2018, në faqen zyrtare të facebook-ut nga I. B.³, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është informuar rreth përmbajtjes së tij, ku ndër të tjera citohet se: “...*Me sharrjet që përdorte kundër meje fillimisht më kujtoi Hanushenë, një jevgë që shante këdo tek rradha e qumështit në dyqanin e lagjes në Gjirokastër...*”

¹ Përfaqësuar nga Kryetari i saj, E. Ç.

² Shkurtesë e Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome

³ https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=1954538548185201&id=100008872243471

Në ankesën ardhur pranë Komisionerit citohet se, me anë të statusit të publikuar nga I. B. në faqen e tij të facebook-ut, ai i drejtohet gazetares R. XH., duke e krahasuar atë me një jevgë që shante këdo në rradhën e qumështit. Sipas LRER, termi i përdorur në tekstin e shkruar nga I. B., përmban elementë diskriminues dhe pezhorativ ndaj komunitetit egjiptian në Shqipëri, pasi ky komunitet njihet zyrtarisht si komunitet egjiptian. Përdorimi i këtij termi nga persona publik, e vendos këtë komunitet në kushtet e një pakice inferiore, mbartëse të vlerave negative dhe nxit forma të ndryshme diskriminimi.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së⁴, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“ Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar në nenin 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet shprehimisht në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe në ligjin Nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*.

⁴ Shkurtesë për ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44, pika 2, të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kritereve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 65, gërma b), të ligjit të sipërpërmendur parashikohet gjithashtu se: *“Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:*

a)

b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative”.

Në pikën 1, të nenit 128, të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” gjithashtu parashikohet koncepti i legjitimitimit edhe kur pala legjitimohet për të nisur një procedim administrativ. Sipas këtij neni, pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj të ligjshëm cenohen nga ky veprim apo mosveprim.

Në rast se do t’i referohemi ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” rezulton se në nenin 32, pika 1, të tij parashikohet shprehimisht se:

“1. Komisioneri ka kompetencë:

a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj;

b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi;

c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligj.”

Referuar parashikimit të gërmës b), të pikës 1, të nenit 32, të ligjit të sipërpërmendur rezulton se Komisioneri shqyrton ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve, ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi.

“Interesi i ligjshëm” është elementi fillestar që duhet të plotësohet nga një organizatë, që depoziton ankesë pranë Komisionerit, për mbrojtje të interesave të një komuniteti të caktuar, që nënkupton legjitimitimin e saj në kryerjen e ankesës.

Nëse do t’i referohemi Vendimit nr. 3754/1, datë 12.04.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nëpërmjet së cilit Shoqata “Lëvizja Rinore Egjiptiane-Rome” është regjistruar si person juridik, konstatohet se objekti kryesor i veprimtarisë së kësaj shoqate është mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive të komunitetit Egjiptian dhe Rom.

Mbështetur në përmbajtjen e statusit të publikuar më datë 30.06.2018 në faqen e facebook-ut të I. B.⁵, citohet: “...Me sharrjet që përdorte kundër meje fillimisht më kujtoi Hanushenë, një jevgë që shante këdo tek rradha e qumështit në dyqanin e lagjes në Gjirokastër....”

Në këtë kontekst, theksojmë faktin se në bazë të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe mbështetur në objektin e veprimtarisë së Shoqatës “Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome”, të përcaktuar saktësisht në vendimin nr. 3754/1, datë 12.04.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Komisioneri gjykon se Shoqata në fjalë, përfaqësuar nga E. Ç. legjitimohet dhe ka tagër për të bërë ankesë në emër të mbrojtjes së të dretave të komunitetit egjiptian dhe rom.

2. Në vijim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës Nr. 1744/1 prot., datë 26.12.2018, kërkoi informacion lidhur me pretendimet e palës ankuese, nga ana e gazetarit I. B..

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, I. B. nuk vuri në dispozicion asnjë informacion, por nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi u konstatua se, subjekti ndaj të cilit është paraqitur ankesa, kishte fshirë publikimin e datës 10.12.2018, për të cilin LRER kishte drejtuar ankesën dhe statusi nuk ekzistonte më.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankesë, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm.

Nga verifikimi i informacioneve dhe dokumentacionit të administruar rezulton se, më datë 10.12.2018, gazetari I. B., ka publikuar një shkrim⁶ në faqen zyrtare të facebook-ut, ku ndër të tjera citon se: “...Me sharrjet që përdorte kundër meje fillimisht më kujtoi Hanushenë, një jevgë që shante këdo tek rradha e qumështit në dyqanin e lagjes në Gjirokastër...”. Me anë të statusit të publikuar në faqen e tij të facebook-ut, I. B. i drejtohet një kolegeje të tij, R. XH., duke e krahasuar atë me një jevgë që shante këdo në rradhën e qumështit.

⁵ https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=1954538548185201&id=100008872243471

⁶ https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=1954538548185201&id=100008872243471

Shqipëria ka nënshkruar Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, e cila në nenin 14⁷, garanton parimin e barazisë dhe detyron shtetet anëtare që të garantojnë gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë pa diskriminim, si dhe Protokollin Nr.12 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, i cili i detyron shtetet anëtare të garantojnë gëzimin e të drejtave pa diskriminim të të drejtave dhe lirive të përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm.

Barazia përpara ligjit është një parim kushtetues i sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë⁸.

Ligji Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ndalon diskriminimin që bazohet në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, pra edhe për shkak të racës dhe që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Në bazë të nenit 3, pika 2 e ligjit Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, sanksionohet se një person apo grup personash diskriminohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, kur trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi përkufizon edhe “*Shqetësimin*”⁹ si formë e diskriminimit që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e mbrojtura, i cili ka për qëllim apo efekt cënimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përcmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cënuar ndaj një sjelljeje të tillë.

Liria e shprehjes, është një e drejtë Kushtetuese e cila garantohet nga neni 22/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kushtetuta sanksionon se të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në të mund të kufizohen. Kushtetuta e lidh kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në të, me detyrimin për të mos tejkaloar kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut¹⁰. **Për këtë arsye, në analizën që i është bërë gjuhës së përdorur në mesazhin e postuar në faqen e facebook-ut, nëse ato do të konsiderohen në tejkallim të lirisë së shprehjes të sanksionuar në nenin 22 të Kushtetutës, i jemi referuar**

⁷ Neni 14, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore - Ndalimi i diskriminimit “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër”.

⁸ Neni 18 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: “Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive”.

⁹ Neni 3 paragrafi 5 i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

¹⁰ Neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

kufizimeve që parashikon Konventa për lirinë e shprehjes, të parashikuar në nenin 10 të saj dhe qëndrimin të mbajtur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi. Sipas paragrafit të dytë të nenit 10 të Konventës, ushtrimi i kësaj lirie nuk mund të çenojë dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka theksuar në gjykime të ndryshme se: *“Toleranca dhe respekti për dinjitetin e barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si çështje parimore mund të konsiderohet e nevojshme në disa shoqëri demokratike që të sanksionojnë ose madje të parandalojnë të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen e bazuar në jo tolerancë ..., me kusht që çdo “formalitet”, “kusht”, “kufizimet ose gjokat” janë proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur. (Erbakan v. Turkey, Aktgjykimi i 6 korrikut 2006, § 56)”. Duke qenë kështu lind nevoja e parandalimit të të gjitha formave të shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen bazuar në mungesën e tolerancës.*

Gjithashtu Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në çështjen Aksu kundër Turqisë ndër të tjera ka theksuar se: *“...rasti nuk ka të bëjë me trajtimin ndryshe ose diskriminues për shkak të racës, pasi kërkuesi në pamje të parë nuk kishte arritur të provonte se botimet kishin një qëllim ose efekt diskriminues...”¹¹*

Në çështjen Handyside v. Mbretërisë së Bashkuar¹², Gjykata bën një dallim mes një nxitjeje serioze për urrejtje apo stigmatizim dhe të drejtës së individëve për të shprehur këndvështrimin në mënyrë të lirë. Gjatë arsyetimit të vendimit Gjykata është shprehur se: *“në funksionet e veta mbikëqyrëse e detyrojnë atë t'i kushtojë vëmendje të madhe, parimeve që karakterizojnë një “shoqëri demokratike”. Liria e shprehjes përbën një nga themelet bazë të një shoqërie të tillë, një nga kushtet bazë për progresin e saj dhe për zhvillimin e çdo njeriu”¹³.*

Pra, shohim se “fjalimet e urrejtjes” kundër personave që i përkasin komunitetit egjiptian, kanë të bëjnë me të gjitha format e shprehjes, të përhapura si nëpërmjet medias, të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtje, diskriminim apo armiqësi ndaj individëve të këtij komuniteti. Vlerësimi nëse shprehje të tilla apo deklarata të caktuara do të konsiderohen si “fjalime të urrejtjes”, duhet të bëhen në përputhje me lirinë e shprehjes të garantuar në nenin 10 të Konventës.

Gjuha e urrejtjes për qëllim të Rekomandimit CRI(2016)15 përfshin përdorimin e një ose të disa formave më të veçanta të shprehjes – si psh, mbrojtja, promovimit apo nxitjes së denigrimit, urrejtje apo shpifje të një personi ose grupi personash, si dhe çdo ngacmim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim apo kërcënim i një personi ose disa personave dhe çdo justifikim të të gjithë

¹¹ https://www.echr.coe.int/Documents/Reports_Recueil_2012-I.pdf (Aksu v. Turkey, Applications nos. 4149/04 and 41029/04)

¹² Handyside v. United Kingdom (application no. 5493/72, datë 07.12.1976.

¹³ Handyside v. United Kingdom (application no. 5493/72, datë 07.12.1976, paragrafi 49, përkthim i Komisionerit.

formave të shprehjes - që është i bazuar në një listë jo shteruese të karakteristikave personale ose statusin që përfshin "raca", ngjyra, gjuha, feja apo besimi, kombësia apo origjina kombëtare ose etnike, si prejardhja, moshë, paaftësia, seksi, gjinia, identiteti gjinor dhe orientimi seksual¹⁴.

Duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuara në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, në referim edhe të evokimit që i bëhet asaj në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë logjike edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilave bëhet interpretimi i Konventës, kanë fuqinë e Konventës.

Në rastin¹⁵ Pihl v. Sweden, GJEDNJ ndër të tjera ka theksuar se: “...edhe pse komenti kishte qenë ofendues, nuk kishte promovuar gjuhë urrejtje ose nxitje për dhunë; ajo ishte postuar në një blog të vogël të drejtuar nga një shoqatë jofitimprurëse; ajo ishte hequr ditën pasi kërkuesi kishte bërë një ankesë; dhe ajo kishte qenë në blog vetëm për rreth nëntë ditë...”

Në statusin e publikuar nga ana e I. B., më datë 10.12.2018, në faqen zyrtare të facebook-ut, ai i drejtohet një kolegeje të tij, R. XH., duke e krahasuar atë me një zonjë që i përkiste komunitetit egjiptian, e cila shante të pranishmit në rradhët e qumështit përpara viteve '90. Në vlerësim të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, I. B. në tekstin e shkruar ka pozicionuar kolegën e tij, në një ngjarje të ndodhur më parë dhe në analizë të tekstit, nuk evidentohet se ka dashur të promovojë apo nxisë urrejtje ndaj një personi ose grupi personash, të cilët i përkasin komunitetit egjiptian. Në analizë të informacionit të sipërcituar, edhe pse qëllimi i tekstit të shkruar nga I. B. nuk ka qenë nxitja e urrejtjes apo qëndrimi diskriminues ndaj komunitetit egjiptian, nga ana e tij janë marrë masat që pas shkresës së dërguar nga KMD, të heq nga faqja tij e facebook-ut statusin e publikuar.

Termi *jevg* ose *evgjit*¹⁶ është një nga mënyrat se si komuniteti egjiptian identifikohet në zona të ndryshme të Shqipërisë. Përdorimi i këtij termi në rastin konkret është bërë për të identifikuar etninë e një personi dhe nuk është shoqëruar me aspekte negative, përçmuese apo denigruese kundrejt komunitetit egjiptian që të mund të përbënin cënim në formën e shqetësimit.

Sa më sipër Komisioneri vlerëson se debati i shëndoshë e i hapur në një shoqëri pluraliste nuk mund të arrihet pa ruajtje të fortë dhe të gjithanshme të së drejtës së lirisë së shprehjes duke patur parasysh gjithmonë ndalimin e të gjitha formave të shprehjes që perhapin, nxisin, promovojnë apo justifikojnë urrejtje, si dhe që përçmojnë apo denigrojnë një komunitet apo përkatësi të

¹⁴ Përkthim i Komisionerit. ECRI General Policy Recommendation No.15 “On combating hate speech” CRI(2016)15. Adopted on 8 December 2015. B.9 Definition (s).

¹⁵ https://www.echr.coe.int/Documents/FS_Hate_speech_ENG.pdf, faqja 16

¹⁶ Në fjalorin e Gjuhës shqipe dy termat përdoren si sinonime dhe përkufizimi që jepet është: *Pjesëtar i një grupi banorësh të disa qyteteve të vendit tonë e të vendeve të tjera të Ballkanit, prejardhjen e të cilëve populli e lidh me Egjiptin.*

caktuar. Sipas standardeve përkatëse të Këshillit të Evropës, edhe kufizimet nga e drejta, synojnë ti shërbejnë interesit më të mirë të një shoqërie demokratike dhe pluraliste.

Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se teksti i shkruar nga ana e I. B. më datë 10.12.2018, gjuha e përdorur dhe qëllimi i saj nuk ka qenë që të nxisë urrejtje apo qëndrim diskriminues dhe shprehjet e përdorura nuk janë të atij niveli që të nxisin qëndrime diskriminuese ndaj komunitetit egjiptian.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 12, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të racës, nga ana e gazetarit I. B., ndaj komunitetit egjiptian.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Raca)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)